

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

Datë 20.11.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”.

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
31681410-0, 44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 408 240 (katër milion e katërëindë e tetë mijë e dyqindë e dyzetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. Formulari i Sigurimit të Ofertes sipas **Shtojcës 3**; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 88,165 (tetëdhjetë e tetë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë e pesë) leke.

c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht **1 763 296 (një milion e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë dyqindë e nëntëdhjetë e gjashtë)** lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 “Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet *(vlera e pritshme e kontratave)* ose **881 648 (tetëqindë e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë e dyzetë e tetë)** lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

3. Kapaciteti teknik:

Adresa: Rruga: “Arben Broci”, Qyteti Studenti, Tiranë, Tel/fax +355 4 2376 214/215/216 www.qytetistudenti.gov.al.

3.3.1. _Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.ISO 9001: 2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë: Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

b.Ofertuesi nepermjet nje deklarate duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin e mallrave prane AK.

Argumentimi: nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Keiter i cili vleresohet i nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kriteret e kërkuara teknike janë për të krijuar bindjen që ofertuesi do të plotësojë objektin sipas kërkesave të AK.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet që: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

SPECIFIKIME TEKNIKE TE MATERIALEVE

A. MATERIALE ELEKTRIKE

Materialet elektrike do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventiv.

Te gjitha materialet duhet te jene cilesore dhe perpara furnizimit duhet te miratohen mostrat per secilin material pastaj te behet furnizimi .

Ne pergjithsi specifikimet e secilit material jane bere ne emertimet e tyre ne preventive , por ne veçanti duhet te plotesohen disa kerkesa si me poshte:

1.Karakteristikat teknike te Llampave duhet te jene si me poshte:

- a) **Llampa led 15w** ,Fuqia 15W,Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500K,Lloji portollampes: E27,Jetegjatesia: 30000 ore pune.
- b) **Llampa led 25w**, Fuqia 25W, Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500K,Lloji portollampes: E27, Jetegjatesia: 30000 ore pune.
- c) **Llampa led 30w**, Fuqia 25W, Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500K,Lloji portollampes: E27, Jetegjatesia: 30000 ore pune.
- d) **Llampat 250w ,70w** duhet te plotesojne 8000-10000 ore pune .

2.Karakteristikat e Kabllit elektrik duhet te jene si me poshte:

- a) **Kabell 3 x 1.5mm**, Model i gomuar, Tensioni 450/750v,
- b) **Kabell 3 x 2.5 mm**, Materiali: Temperatura e punes: +5*C - +60*C,Tensioni 450/750V

- c) **Kabell 4 x 4 mm.** Materiali i izolimit:PVC T12/Pvac TM2, Temperatura e punes: +5*C-+60*C, Tensioni 450/750V

3.Karakteristikat teknike të Plafonieret të jenë si më poshtë:(Inkaso ,te jashtem dhe gipsi)

- a) **Plafonier i jashtem Led 60x60**, Fuqia 50W, Forma: Katror, Ndricimi 6500K,Jetegjatesia 30000ore pune.(Te jene te kompletuar me ushqyes)
- b) **Plafonier inkaso Led 60x60**, Fuqia 50W, Forma: Katror, Ndricimi 6500K,Jetegjatesia 30000ore pune.(Te jene te kompletuar me ushqyes), Nje pjese prej 50copesh duhet te jene per tavane gipsi qe montohen me kllapa.
- c) **Plafonier Led 28x28, Fuqia 24W**, Forma: Katror, Ndricimi 6500K,Jetegjatesia 30000ore pune. .(Te jene te kompletuar me ushqyes)
- d) **Spot led gipsi 18W**, Forma: Rrethor, Ndricimi: 6500K, Jetegjatesia 30000ore pune. Te montohen Brenda gipsit me kllapa..(Te jene te kompletuar me ushqyes)
- e) **Drozelat 50w, 24w, 18w** : Kokat e lidhjeve me Plafonieret duhet te jene te llojeve te ndryshme sipas kerkeses.

4.Karakteristikat teknike të Termostateve dhe Rezistencave duhet të jenë si më poshtë:

- a) **Termostat 20A te rumbullaket** ,20A ,220V, Temperatura:80*, Modeli: Universal
- b) **Termostat 20A katror** ,20A ,230V, Temperatura:80*, Modeli: Universal
- c) **Termostat 3F 20 (3,3)A 400V TR 7-75*C** (duhet mar mostra ne vend ne bolierin e Godines 6)
- d) **Rezistence 1.5kW**: Materiali: Baker Tipi:Rezistence me vide te gjate , Fuqia 1500w

5.Karakteristikat teknike te Leshuesve duhet te jene si me poshte:

- a) **Leshues 63A 4P 220v-240v**

6.Karakteristikat teknike të Salvavitave të jenë si më poshtë:

- a) **Salvavit 63A 3F 4P** ~ 230v - 400v
- b) **Salvavit 40A monofaze** ~ 230v - 400v

7.Fashetat Plastike,Klema sy,Klema fundore,Terminal i izoluar duhet te jene si me poshte:

- a) Duhet te jene te madhesive te ndryshme.

8. Karakteristikat teknike te Nastro e madhe duhet te jene si me poshte:

- a) **Nastro e madhe** : Material PVC, Gjeresia 15mm, Gjatesia 25m.

9. Karakteristikat teknike te Pompe 12/6, Grup furnizimi te jene si me poshte:

- a) **Pomp qarkulluese 12/6** , Kompletuar me Kontesator. I: 63W/ 0.28A , II: 86W/ 0.38A
b) **Grup furnizimi automatik**: Me dalje ½, Me manometer presioni , Material :Bronx.

10. Karakteristikat teknike te Pomp uji 1.5kW te jene si me poshte:

- a) **Pomp uji** : Fuqi: 1.5 kw me dalje 2 poleshe Lartesia max 18 metra Prurja 500 litra/min

B. MATERIALE HIDRAULIKE

Materialet hidraulike do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventiv .

Te gjitha materialet duhet te jene cilesore dhe perpara furnizimit duhet te miratohen mostrat per secilin material pastaj te behet furnizimi .

Ne pergjithesi specifikimet e secilit material jane bere ne emertimet e tyre ne preventiv , por ne veçanti duhet te plotesohen disa kerkesa si me poshte:

1. **Kaseta plastike per Wc**: Te kompletuara me Material plastic,Kapaciteti 6-10L.
2. **Kapak Wc plastik** : Ngjyra e bardhe, Materiali Rezine/polipropilen, Te perfshihen menteshat.
3. **Grupet e dushit** : Duhet te jene material bronxi , te kompletuar me zorra ,koka dushi dhe mbajtese koka dushi.
4. **Grupet e Lavamanit**., Duhet te jene material bronxi, te kompletuar me tuba fresibel.
5. **Grupet e Lavapjatis**: Duhet te jene material bronxi, te kompletuar me tuba fresibel.

Adresa: Rruga: "Arben Broci", Qyteti Studenti, Tiranë, Tel/fax +355 4 2376 214/215/216 www.qytetistudenti.gov.al.

6. **Sifonet me pilete:** Duhet te jene Materiali: PP(polipropilen),Te kete dhe pileten e perfshire ne paketim.
7. **Sifon set lavapjati me dy pileta Ø40 :** Duhet te jene Materiali: PP(polipropilen),Te kete dhe piletat e perfshira ne paketim.
8. **Kokat e dushit:** Duhet te jene me vide ne mese (te meret mostra ne magazine).
9. **Kokat e dushit 20x20cm:** Duhet te jene material Inoksi, rezistente nga presioni dhe nxehtesia..
10. **Zorra dushi:** Material Inoks, Tipi:Me dado bronxi, Gjatesi 150cm.
11. **Saracineskat:** Duhet te jene bronxi.
12. **Tubat fresibel:** Te perballojne presionin 6bar,Material : Inoksi.
13. **Rubinetat e thjeshta:** Te jene bronxi me leve ose pallot .
14. **Guarnicionet ½ , ¾ , flanaxhe 6,8 vrima:** Duhet te jene material gome, forma rethore.
15. **Minifiltra:** Duhet te jene material bronxi me diameter 1/2.
16. **Manikotat Ø20, Ø25:** duhet te jene material plastic dhe me ngjitje.
17. **Bulitor 500L me serpentina :** Te jete i kompletuar me te gjithë aksesoret (rezistence ,thermostat, k/valvol,guarnicione ,tapa).

18. **Reduksionet 1' x 1/2, 1' x 3/4:** Te gjitha duhet te jene xingato.
19. **Valvolat e presionit te larte:** Duhet te jene material bronxi.
20. **Kundra valvul bolieri:** Duhet te jete material bronxi dhe diameter ne hyrje 1/2 .
21. **Ngjitës për PVC:** Te jene me tubeta 125gr.
22. **Silikon:** Transparent ngjites duhet te jete material antimyk.
23. **Kapak pusete plastic:** Te jene diameter 40x40cm, Material polipropilen
24. **Galixhanti per kaset Wc:** Lidhja me tubin fleksibël: Bronz
25. **Zgjatueset 1.5cm 3cm:** duhet te jene xingato.
26. **Wc allafrenga:** Material Porcelan Forma Ovale, Aksesorët e fiksimit përfshihen në paketim.
27. **Lavaman 50cm:** Materiali: Porcelan, Ngjyra: E bardhë, Gjerësia: 50 cm

C. MATERIALET E LAVANTERISE & VEGLAT E PUNES.

Materialet e Lavanterise do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventiv dhe te meret moster per cdo Emertim.

Te gjitha materialet duhet te jene cilesore dhe perpara furnizimit duhet te miratohen mostrat per secilin material pastaj te behet furnizimi .

Materialet Vegla Pune

1. **Set me kacavida**, : Materiali: Celik special veglash, Te veshura me oksid te zi, per te eliminuar demtimin e kokes se vides dhe majes se kacavides
2. **Çelës hidraulik, papagall** : Materiali: Çelik-Karbon , Përmasat: 12”
3. **Çelës hidraulik, papagall**: Materiali: Çelik-Karbon , Përmasat: 14”
4. **Çelës hidraulik anglez**, : Materiali: Krom-Vanadium , Përmasat: 8”
5. **Cekic me doreze druri** : Materiali i çekiçit: Celik veglash Cr-Mo,Pesha:400g
6. **Daltë guri**: Materiali: Çelik
7. **Çizme gjuetie, peshkimi** : Materiali: Poliestër/Plastik ,Ngjyra: Jeshile, Përmasat: nr 44-45. Që të mund të përdoren për të kaluar vende ku lartësia e ujit është e madh, perdoren për të pastruar vende si kanale puseta etj
8. **Pelerine shiu** : Ngjyra jeshile, Mbyllje me zinxhir. Prodhuar nga 65% PVC dhe 35% poliester. Me densitet te larte prej 350 g/m2.

Lëvrimi: Brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese është të kujdeset për mirëmbajtjen e godinave të RSU Nr.1. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi i mirembajtjes ka nevoja për pajisjen me materialet e domosdoshme elektrike dhe hidraulike. Materialet elektrike dhe hidraulike duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **06.12.2023, ora 12:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

KOMISIONI